



Banka e Shqipërisë


METODOLOGJI*

*Mbi mënyrën e llogaritjes dhe të ndryshimit të rëndësisë sistemike të bankave dhe të shtesës përkatëse makroprudenciale të kapitalit***

* Kjo metodologji publikohet në mbështetje të Rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit" të miratuar me Vendim nr. 41, datë 05.06.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Në nenin 4, paragrafi (1), nenparagrafi (16), të kësaj Rregulloreje thuhet: "Bankat me rëndësi sistemike janë bankat e përcaktuara me rëndësi sistemike sipas një metodologjie të caktuar të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 14."

**Ndryshuar titulli i metodologjisë sipas dokumentit të miratuar nga Zëvendësguvernatori i Dytë i Bankës së Shqipërisë, nr.prot.828, datë 01.02.2024

.....



.....

P Ë R M B A J T J A

I.	KRIZA FINANCIARE DHE BANKAT ME RËNDËSI SISTEMIKE	4
II.	PËRVOJA ME D-SIBS	6
III.	METODOLOGJIA E BANKËS SË SHQIPËRISË PËR IDENTIFIKIMIN E BARS (DSIBS)	7
IV.	LLOGARITJA E SHITESËS SË KAPITALIT (SIST) PËR BANKAT ME RËNDËSI SISTEMIKE (BARS)	16
V.	PROCESI I ZBATIMIT	21
ANEKS 1.	KRONOLOGJIA E ZHVILLIMEVE LIDHUR ME KUADRIN E INSTITUCIONEVE FINANCIARE ME RËNDËSI SISTEMIKE (SIFIS)	22
ANEKS 2:	PARIMET E KOMITETIT TË BAZELIT PËR MBIQYRJEN BANKARE (BCBS) PËR TRAJTIMIN E BANKAVE ME RËNDËSI SISTEMIKE NË NIVEL LOKAL (BARS)	24
ANEKS 3:	QASJET NË PËRCAKTIMIN E TREGUESVE DHE NËNTREGUESVE TË RËNDËSISË SISTEMIKE, SIPAS BCBS, EBA DHE BSH	26
ANEKS 4:	MËNYRA E VEPRIMIT PËR LËVIZJEN E BANKAVE DREJT OSE JASHTË GRUPIT TË BANKAVE ME RËNDËSI SISTEMIKE	27



Ky material paraqet metodologjinë e përdorur nga Banka e Shqipërisë për të identifikuar bankat me rëndësi sistemike (BARS)¹ që kryejnë aktivitet në territorin e Shqipërisë, si edhe për të llogaritur shtesën e kapitalit që rekomandohet të aplikohet për këto banka në varësi të shkallës së rëndësisë sistemike (SIST)². Nota e rëndësisë sistemike është llogaritur sipas metodologjive të hartuara nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare dhe nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA³) dhe përmban treguesit e madhësisë, ndërlidhjes, zëvendësueshmërisë dhe kompleksitetit. Për përcaktimin e kufirit ndarës midis bankave sistemike dhe bankave josistemike është shfrytëzuar koncepti i 'bankës referencë'.

Për të llogaritur shtesën e kapitalit për secilën shportë është ndjekur kuadri i ndikimit të pritshëm, në thelb të së cilit qëndron objektivi për ta bërë ndikimin e pritshëm sistematik nga falimentimi i një banke sistemike të krahasueshëm me ndikimin e pritshëm nga falimentimi i një banke josistemike nëpërmjet aplikimit të kërkesave për kapital shtesë për përthithjen e humbjeve ndaj bankave me rëndësi sistemike.

I. KRIZA FINANCIARE DHE BANKAT ME RËNDËSI SISTEMIKE

1. Një nga mësimet kryesore të krizës financiare botërore ishte nevoja për të adresuar në kohë dhe në mënyrë eficiente problemet që shkakton në sistemin financiar dhe në ekonominë reale falimentimi ose mosfunksionimi normal i institucioneve financiare me rëndësi të veçantë, të ashtuquajtura institucione me rëndësi sistemike (SIFI4). Rëndësia sistemike e këtyre institucioneve lidhet jo vetëm me madhësinë e tyre, por edhe me kompleksitetin e shërbimeve dhe instrumenteve që ato ofrojnë, shkallën e lartë të ndërlidhjes midis tyre dhe me subjekte të tjera të sistemit financiar lokal dhe botëror, dhe me vështirësinë e zëvendësimit të tyre nga subjekte të tjera në mënyrë të shpejtë dhe efektive, në rast falimentimi. Në shumë vende, qeveritë u detyruan të ndërhynin me mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për të kufizuar dëmet dhe përhapjen e rrezikut në segmente të tjera të sistemit financiar.
2. Perceptimi që këto institucione janë shumë-të-mëdha-për të falimentuar (too-big-to-fail) dhe që ato gëzojnë privilegjin e mbështetjes nga

¹ Sipas Nenit 4, paragrafi (1), nënparagrafi (16), të Rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit" të miratuar me Vendim nr. 41, datë 05.06.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bankat sistemike shënohen me akronimin "BARS";

² Sipas Nenit 4, paragrafi (1), nënparagrafi (17), të Rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit" të miratuar me Vendim nr. 41, datë 05.06.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shtesa e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike shënohet me akronimin "SIST" dhe është sasia e kapitalit që një BARS duhet të mbajë në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë (KBN1), përtej shtesës konservuese të kapitalit (KONS), sipas nenit 14; ajo shprehet në përqindje, si raport ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun të bankës.

³ European Banking Authority

⁴ Systemically Important Financial Institutions



shteti në rast vështirësish, rezulton në të ashtuquajturin rrezik moral që reflektohet në marrjen përsipër të rrezikut më të lartë nga ana e këtyre institucioneve, cënim të disiplinës së tregut, dëmtim të konkurrencës dhe rritje të mundësisë për falimentim në të ardhmen. Për këto arsye, u bë e qartë që SIFs do të duhej t’iu nënshtroheshin masave të veçanta prudenciale që kanë në fokus (a) zvogëlimin e rrezikut sistematik që vjen nga dështimi i tyre, si edhe (b) pakësimin e rrezikut moral të përmendur më lart.

3. Në përgjigje të krizës, u hartua një paketë masash e njohur si Basel III, kërkesat e së cilës forcojnë tre shtyllat e Basel II me synim përmirësimin e qëndrueshmërisë së bankave dhe sistemit bankar. Në tetor të vitit 2010, Bordi i Stabilitetit Financiar (FSB⁵) i rekomandoi të gjitha vendeve anëtare të hartonin një kuadër masash për të pakësuar rreziqet e lidhura me SIFs në juridiksionin e tyre. FSB i kërkoi BCBS të zhvillonte një metodologji të mbështetur mbi tregues cilësorë dhe sasiorë për të vlerësuar rëndësinë sistematike të institucioneve më rëndësi sistematike në nivel botëror⁶ së bashku me një vlerësim të madhësisë së kapitalit për përthithjen e humbjeve që mund të ngrihej nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të ndryshme.
4. Metodologjitë dhe përcaktimet e lidhura me bankat me rëndësi sistematike në nivel lokal (D-SIBs⁷) dhe institucionet e tjera me rëndësi sistematike (O-SIFs⁸) kanë rrjedhur nga kuadri për bankat/institucionet me rëndësi sistematike në nivel botëror (G-SIBs⁹) i zhvilluar fillimisht nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare (BCBS) dhe i plotësuar më tej nga EBA (për më shumë informacion, shiko Aneksin 1).
5. Për D-SIBs, BCBS i rekomandon vendeve të identifikojnë bankat me rëndësi sistematike në juridiksionin e tyre, si edhe të formulojnë një regjim rregullator dhe mbikëqyrës të tillë që të ulë rrezikun e falimentimit të tyre duke shtuar kapacitetet për përthithjen e humbjeve. Gjithashtu, BCBS rekomandon që për vlerësimin e notës së rëndësisë sistematike për D-SIBs vendet të përdorin treguesit e madhësisë, ndërlidhjes, zëvendësueshmërisë, dhe kompleksitetit (duke përfshirë aktivitetin ndër-kufitar), si edhe tregues të tjerë që autoritetet kombëtare i konsiderojnë të rëndësishme për profilin dhe aktivitetin e bankave që veprojnë në juridiksionin e tyre (për më shumë, shiko Aneksin 2).
6. Kuadri metodologjik dhe rregullator për D-SIBs mbështetet mbi dy akte të rëndësishme të hartuara nga BCBS dhe EBA. Në vitin 2012, BCBS publikoi një qarkore që trajton metodologjinë për përcaktimin

⁵ Financial Stability Board

⁶ Global Systemically Important Financial Institutions – SIFIs

⁷ Domestic Systemically Important Banks.

⁸ Other Systemically Important Institutions

⁹ Global Systemically Important Banks



e bankave me rëndësi sistemike në nivel lokal¹⁰ ndërsa në vitin 2014, EBA publikoi Udhëzuesit "Mbi kriteret për të përcaktuar kushtet e aplikimit të Artikullit 131(3) të Direktivës 2013/36/EU¹¹ në lidhje me vlerësimin e O-SIIs". Ndërkohë që të dy aktet shtjellojnë treguesit, nëntreguesit, peshat dhe mënyrën e llogaritjes së notës së rëndësisë sistemike, udhëzimi i EBA-s përcakton për herë të parë kufirin sasior që vendet anëtare të Bashkimit Evropian duhet të përdorin për të identifikuar D-SIBs që kryejnë aktivitet brenda secilit shtet.

II. PËRVOJA ME D-SIBS

7. Pjesa më e madhe e vendeve brenda dhe jashtë Bashkimit Evropian, aktualisht aplikojnë metodologji të mbështetura mbi kornizën e zhvilluar nga Komiteti i Bazelit dhe nga EBA për të llogaritur rëndësinë sistemike të bankave që kryejnë aktivitet në territorin e tyre (D-SIBs).
8. Në vitin 2016, EBA publikoi për herë të parë listën e D-SIBs të identifikuar nga vendet anëtare të BE-së si edhe shtesat e kapitalit për rëndësinë sistemike, të caktuara nga autoritetet kombëtare për secilën bankë sistemike. Kjo listë azhurnohet çdo vit.
9. Shtesa e kapitalit për rëndësinë sistemike ka një rëndësi të vecantë, sepse ajo iu kërkohet bankave përsa kohë ato vlerësohen me rëndësi sistemike, në ndryshim nga shtesa konservuese e kapitalit dhe shtesa kundërciklike e kapitalit, të cilat kanë për qëllim të përthithin humbjet në rastet kur aktiviteti financiar (dhe ekonomik) pëson rënie të ndjeshme.
10. Nga lista e publikuar nga EBA vërehet se pjesa më e madhe e vendeve kanë aplikuar në mënyrë rigoroze Udhëzimet e EBA-s për identifikimin e D-SIBs, megjithatë në disa raste, autoritetet lokale kanë ushtruar gjykimin mbikëqyrës për të zgjeruar listën e përfshirë nga aplikimi i metodologjisë, me subjekte të tjera me notë më të ulët sesa kufiri sasior i EBA-s.
11. Pjesa më e madhe e vendeve kanë zbatuar parimin e proporcionalitetit duke aplikuar kërkesa më të mëdha për kapital shtesë për D-SIBs me notë më të lartë të rëndësisë sistemike. Megjithatë disa shtete kanë vendosur të aplikojnë të njëjtën masë të kërkesës për kapital shtesë për të gjitha D-SIBs pavarësisht madhësisë relative të tyre¹².

¹⁰ A framework for dealing with domestic systemically important banks, October 2012

¹¹ Capital Requirements Directive

¹² Norvegji (2%), Suedi (2%), Greqi (1%), Rumani (1%).



-
12. Në disa vende, shtesa në kapital për rëndësinë sistemike i është mbivendosur shtesës për rrezikun sistematik në nivel sektori. Në Norvegji dhe Suedi bankat i nënshtrohen kërkesës për një shtesë të veçantë prej 3% për rrezikun sistematik, të cilën D-SIB-s duhet ta mbajnë krahas shtesës prej 2% për rëndësinë sistemike.

III. METODOLOGJIA E BANKËS SË SHQIPËRISË PËR IDENTIFIKIMIN E BARS¹³ (DSIBS)

13. Në vitet 2012 - 2013 Banka e Shqipërisë (BSh) bëri përpjekjet e para për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike duke shfrytëzuar metodën empirike CoVaR. Sipas kësaj metodologjie, në rast se kontributi marzhinal i një institucioni në rrezikun sistematik, të matur nga Indeksi i Fortësisë Financiare¹⁴, është i lartë, atëherë institucioni konsiderohet si institucion me rëndësi sistemike. Kontributi marzhinal i 6 bankave më të mëdha në rrezikun sistematik, është diferenca midis vlerës së treguesit të bankës në kushte normale dhe vlerës së treguesit të bankës në situatë stresi. Tre nga gjashtë bankat e mëdha të përfshira në ushtrim rezultuan të jepnin një kontribut të konsiderueshëm në rrezikun sistematik të sektorit bankar.
14. Nevoja për të kalibruar intensitetin e mbikëqyrjes me profilin dhe nivelin e rrezikut të bankave, dhe, në mënyrë të veçantë, detyrimi për të zbatuar Udhëzimin "Për Planet e Rimëkëmbjes"¹⁵ bëri që në vitet 2013 – 2014 dhe me mbështetjen e misioneve FinSAC/ Banka Botërore dhe FSAP (FMN) BSh të punonte për zhvillimin e metodologjisë së identifikimit të bankave me rëndësi sistemike sipas përqasjes së bazuar në tregues¹⁶, të hartuar nga BCBS.

NOTA E RËNDËSISË SISTEMIKE: METODOLOGJIA

15. Sipas metodologjisë, nota e rëndësisë sistemike (NRS) për secilën bankë të sektorit bankar vendas llogaritet si një tregues i agreguar i treguesve të **madhësisë, ndërlidhjes, zëvendësueshmërisë dhe kompleksitetit**. Secili prej treguesve përfshin një ose disa nëntregues që kapin aspekte të ndryshme të aktivitetit të sektorit bankar të lidhura

¹³ Për të siguruar konsistencë me bazën ligjore të aplikueshme në Shqipëri, në pjesën e materialit që trajton metodologjinë e ndjekur nga Banka e Shqipërisë, për bankat me rëndësi sistemike përdoret akronimi BARS, i përcaktuar në Rregulloren "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit" të miratuar me Vendim nr. 41, datë 05.06.2019, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe jo akronimi ndërkombëtar DSIBs.

¹⁴ Indeksi i Fortësisë Financiare ndërthur në një tregues të vetëm 6 nëntregues që masin: cilësinë e aktiveve, likuiditetin, rrezikun e kursit të këmbimit, përfitueshmërinë, mjaftueshmërinë e kapitalit dhe rrezikun e normës së interesit.

¹⁵ Udhëzimi "Për Planet e Rimëkëmbjes" i miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, dt. 26.02.2014. Ky udhëzim përcaktonte që subjekte të tij ishin bankat dhe degët e bankave të huaja të përcaktuara si banka me rëndësi sistemike nga Administratori përkatës i BSh për qëllime të këtij udhëzimi.

¹⁶ Indicator-based approach.



me treguesin përkatës. Në vlerësimin e parë të NRS, rekomandimi për të marrë në konsideratë tregues që kapin veçoritë e sektorit bankar vendas u adresua nëpërmjet zëvendësimit të treguesit "Aktiviteti ndërkufitar" të metodologjisë së GSIBs me treguesin "Ndjeshmëria lokale". Komiteti i Bazelit rekomandon që, vende me treg bankar me nivele të larta përqendrimi, të përfshijnë edhe tregues të përqendrimit në llogaritjen e notës së rëndësisë sistemike. BSh nuk ka përfshirë një tregues të tillë në listën e treguesve të rëndësisë sistemike, duke qenë se monitorimi i vazhdueshëm i përqendrimit tregon se sektori bankar shqiptar ka një nivel të ulët përqendrimi për pjesën dërrmuese të produkteve. Për një vlerësim më të plotë dhe për shkak të rritjes së shpejtë të disa zërave, si për shembull të kredisë për jorezidentët, gjatë viteve të fundit, të gjithë treguesit dhe nëntreguesit përfshijnë edhe aktivitetin e bankave vendase me jorezidentët.

16. Disa vende kanë zgjedhur të përdorin pesha më të mëdha për treguesit dhe nëntreguesit, që i vlerësojnë më të rëndësishëm për të identifikuar madhësinë dhe/ose rëndësinë e bankave nga këndvështrimi i rrezikut sistematik. Një metodë alternative për përcaktimin e peshave të treguesve është ajo e entropisë, e cila iu jep peshë më të madhe treguesve që shfaqin përqendrim më të lartë, ose që bëjnë diferencim më të mirë midis bankave. Nga krahasimi i rezultateve të NRS-së të llogaritur me pesha të barabarta dhe me pesha sipas metodës së entropisë, u arrit në përfundimin që dallimet ishin të parëndësishme. Në interes të thjeshtësisë dhe transparencës së ushtrimit, BSh do të përdorë pesha të barabarta për treguesit dhe pesha të ndryshme për nëntreguesit brenda treguesve, në rastet kur metodologjia standarde është modifikuar për të reflektuar karakteristikat e sektorit bankar dhe ekonomisë vendase. Përdorimi i peshave të barabarta për treguesit është në përputhje me rekomandimet e Komitetit të Bazelit dhe EBA-s. Për të gjithë nëntreguesit, për secilën bankë, llogaritet pesha e vlerës së bankës për atë nëntregues, ndaj vlerës së përgjithshme të sistemit për treguesin përkatës¹⁷. Për llogaritjen vlerës së secilit tregues për çdo bankë shumëzohet pesha e bankës për secilin nëntregues me peshën e atij nëntreguesi brenda treguesit përkatës.

17. Treguesit e përdorur për të llogaritur NRS si edhe nëntreguesit që përbëjnë çdo tregues, së bashku me shpjegimet përkatëse për të dhënat dhe arsyen e zgjedhjes së secilit janë si në vijim (në mënyrë të përmbledhur ky informacion paraqitet në Aneksin 3):

17.1 **Madhësia** e një institucioni financiar ose banke është në përpjesëtim të drejtë me dëmin ose rrezikun që falimentimi i këtij subjekti sjell për sistemin financiar dhe për ekonominë në tërësi.

¹⁷ Për shembull, për treguesin 'Kredia për sektorin privat' llogaritet pesha e vlerës së kredisë së dhënë për sektorin privat (individë dhe biznese) nga banka përkatëse ndaj vlerës së kredisë së përgjithshme për sektorin privat të dhënë nga sektori bankar.



17.1.1 **Përkufizimi:** Si EBA, ashtu edhe Komiteti i Bazelit rekomandojnë përdorimin e një treguesi të vetëm për të kapur madhësinë e subjekteve. Komiteti i Bazelit rekomandon përdorimin e ekspozimeve totale sipas përkufizimit për përdorim në raportin e levës financiare të Bazelit III, ndërsa EBA rekomandon përdorimin e aktiveve totale. Vende të ndryshme e kanë përshtatur këtë tregues me veçoritë e sektorit bankar kombëtar, duke përdorur peshën e aktiveve ndaj PBB-së, peshën e depozitave ndaj PBB-së, peshën e kredisë ndaj PBB-së ose tregues të agreguar me pesha të njëjta ose të ndryshme.

17.1.2 **Përfaqja e BSh:** Për të ndërtuar treguesin e “Madhësisë”, në përputhje me metodologjinë e EBA-s dhe Komitetit të Bazelit është përdorur vetëm një nëntregues i përkufizuar si “Totali i aktiveve duke përfshirë zërat jashtë bilancit”¹⁸. Totali i zërave jashtë bilancit është një tregues që haset në metodologjinë e disa vendeve. Në rastin e Shqipërisë përfshirja e zërave jashtë bilancit është motivuar me: 1) madhësinë e zërave jashtë bilancit në raport me vlerën e përgjithshme të aktiveve të sektorit; 2) dallimet e konsiderueshme në vlerat e zërave jashtë bilancit nga banka në bankë dhe nga periudha në periudhë. Tregues të tjerë të madhësisë si “Totali i depozitave” apo “Totali i kredisë” përgjithësisht shfaqin korrelacion të fortë me totalin e aktivitetit¹⁹, dhe përfshirja e tyre si tregues të veçantë brenda kësaj kategorie nuk sjell vlerë të shtuar në aftësinë e treguesit “Totali i aktiveve duke përfshirë zërat jashtë bilancit” për të kapur madhësinë e subjekteve. Treguesi i përzgjedhur, duke qenë i vetmi në treguesin e “Madhësisë”, merr një peshë prej 25% nga pesha e përgjithshme prej 100% e NRS-së.

17.2 **Ndërlidhja** midis bankave dhe institucioneve financiare është në përpjesëtim të drejtë me rrezikun sistematik që paraqet secili subjekt. Problemet financiare të një subjekti mund të rrisin probabilitetin e falimentimit ose problemeve për institucionet e tjera për shkak të rrejtimit të detyrimeve kontraktuale midis institucioneve që mundësojnë përcjelljen e stresit.

17.2.1 **Përkufizimi:** Si EBA, ashtu edhe Komiteti i Bazelit rekomandojnë përdorimin e tre nëntreguesve brenda treguesit të “Ndërlidhjes”: ‘Aktivet brenda sistemit financiar’, ‘Detyrimet brenda sistemit financiar’ dhe ‘Investimet në letrat me vlerë/letrat me vlerë të borxhit’.

17.2.2 **Përfaqja e BSh:** Për të ndërtuar treguesin e “Ndërlidhjes”, janë përdorur tre nëntregues: ‘Aktivet brenda sistemit financiar’, ‘Detyrimet brenda sistemit financiar’ dhe ‘Financimi i bankave nëpërmjet borxhit

¹⁸ Ky përkufizim i “Madhësisë” është përdorur, për shembull, nga Banka Qendrore e Omanit. Shiko “Domestic Systemically Important Banks (D-SIBs), Framework for Oman”, Janar 2015.

¹⁹ Me fjalë të tjera, pesha e aktiveve të një banke ndaj aktiveve të sektorit bankar, tenton të jetë e përafërt me peshën e asaj banke në tregun e kredisë dhe depozitave në sektorin bankar.



në formën e kapitalit dhe letrave me vlerë të lëshuara nga bankat'. Secili nëntregues brenda këtij treguesi ka një peshë prej 8.33% duke qenë se të tre nëntreguesit konsiderohen si të barazvlefshëm për nga aftësia për të kapur ndërlidhjen e bankave me njëra tjetrën dhe të bankave me sektorë të tjerë të ekonomisë.

17.3 **Shkalla e zëvendësueshmërisë** së një pjesëmarrësi tregu është në përpjesëtim të zhdrejtë me pasojat që sjell falimentimi i këtij subjekti në sistemin financiar. Shkalla e zëvendësueshmërisë tregon lehtësinë me të cilën një subjekt mund të zëvendësohet si pjesëmarrës tregu dhe si ofruer shërbimesh për publikun. Për shembull, sa më i madh të jetë roli i një banke në një linjë të caktuar biznesi ose në një kategori të caktuar shërbimesh (p.sh. pagesa) aq më i madh do të jetë ndikimi negativ që do të kishte falimentimi i kësaj banke në gamën dhe cilësinë e shërbimeve dhe në likuiditetin e infrastrukturës së tregut. Gjithashtu, sa më e madhe të jetë shtrirja e një banke në një segment të caktuar shërbimesh, aq më e vështirë është për klientët e kësaj banke të sigurojnë të njëjtin shërbim nga operatorë të tjerë të sistemit financiar.

17.3.1 **Përkufizimi:** Për të ndërtuar treguesin e "Zëvendësueshmërisë" për G-SIBs, Komiteti i Bazelit rekomandon përdorimin e 'Aktiveve nën kujdestari', 'Pagesave të kryera dhe të shlyera nëpërmjet sistemit të pagesave' dhe 'Vlerës së transaksioneve të nënshkruara në tregjet e borxhit dhe të kapitalit'. Në Udhëzuesin për DSIBs, EBA rekomandon përdorimin e 'Vlerës së transaksioneve të pagesave të brendshme', 'Depozitat e sektorit privat nga BE' dhe 'Kreditë e marra nga sektori privat brenda BE-së' për të llogaritur treguesin e "Rëndësisë", i cili përfshin zëvendësueshmërinë dhe infrastrukturën e sistemit financiar.

17.3.2 **Përçqasja e BSh:** Për të ndërtuar treguesin e "Zëvendësueshmërisë" janë përdorur shtatë nëntregues, me peshat përkatëse, si në vijim²⁰: 'Kredia për sektorin privat' (5%), 'Depozitat e sektorit privat' (5%), 'Vlera e transaksioneve të pagesave' (5%), 'Numri i transaksioneve të pagesave' (2.5%), 'Investimet e bankave në bursë dhe pjesëmarrja në shoqëritë administruese të fondeve' (2.5%), 'Aktivet nën kujdestari' (2.5%) dhe 'Aktivet e fondeve të investimit/pensioneve që janë në pronësi të bankës' (2.5%). Përfshirja e tre nëntreguesve të fundit në këtë kategori është bërë për të mundësuar një vlerësim të rëndësisë dhe shkallës së ndërlidhjes së bankave me segmente të tjera të sistemit financiar. Përcaktimi i peshave të nëntreguesve të përfshirë në këtë tregues është bërë në bazë të rëndësisë relative të secilit nëntregues/fenomen në gamën e aktiviteteve dhe shërbimeve që kryhen nga bankat vendase.

²⁰ Pas çdo treguesi, në kllapa, është paraqitur pesha e atij treguesi.



17.4 **Kompleksiteti** i një banke, i reflektuar në modelin e biznesit, strukturën dhe kuadrin operacional të saj, është në raport të drejtë me ndikimin sistematik të falimentimit të kësaj banke. Sa më kompleks të jetë një subjekt financiar, aq më shumë kohë dhe fonde nevojiten për të zgjidhur bankën dhe për të trajtuar problemet e shkaktuara nga falimentimi i saj në sistemin financiar.

17.4.1 **Përkufizimi:** Për të ndërtuar treguesin e "Kompleksitetit" për G-SIBs, Komiteti i Bazelit rekomandon përdorimin e nëntreguesve 'Vlera nominale e derivativëve mbi banak', 'Aktivet e nivelit të tretë' dhe 'Letrat me vlerë të mbajtura për tregtim dhe të vlefshme për shitje'. Për të njëjtin tregues, për llogaritjen e NRS-së për DSIBs, EBA rekomandon përdorimin e nëntreguesve 'Vlera nominale të derivativëve mbi banak', 'Pretendime ndaj jorezidentëve' dhe 'Detyrime ndaj jorezidentëve'.

17.4.2 **Përfaqja e BSh:** Për të ndërtuar treguesin e "Kompleksitetit", janë përdorur katër nëntregues me peshat përkatëse, si në vijim: 'Pretendime ndaj jorezidentëve' (10%), 'Detyrime ndaj jorezidentëve' (5%), 'Derivativa mbi banak' (2.5%) dhe 'Investime jo-likuide'²¹ (7.5%). Ky tregues përfshin nëntregues të sugjeruar nga të dyja metodologjitë e marra si referencë për treguesin e "Kompleksitetit", ndërsa peshat e secilit nëntregues brenda treguesit reflektojnë rëndësinë relative të secilit aktivitet/nëntregues në aktivitetin e sektorit bankar vendas.

17.5 **Ndjeshmëria lokale** është një përmasë tjetër e rekomanduar nga Komiteti i Bazelit, si një tregues që kap faktorë dhe fenomene specifike të vendit dhe sistemit financiar, për të cilin kryhet vlerësimi. Shumë vende përdorin 'Depozitat e individëve' për të vlerësuar perceptimin që publiku mund të ketë për pasojat lokale të falimentimit të një banke. Ky informacion është përdorur edhe nga BSh për të kuantifikuar treguesin e "Ndjeshmërisë lokale" në vlerësimet e para të NRS-së. Në vlerësimin aktual të NRS-së, për të ruajtur krahasueshmërinë me formatin e propozuar nga EBA për DSIBs, nëntreguesi 'Depozitat e individëve' është përfshirë në nëntreguesin 'Depozitat e sektorit privat' brenda treguesit të "Zëvendësueshmërisë" dhe treguesi i "Ndjeshmërisë lokale" është hequr nga lista e treguesve të NRS-së.

18. Në vijim të përshkrimit të mësipërm, treguesit e përdorur për të llogaritur NRS-në si edhe nëntreguesit që përbëjnë çdo tregues, së bashku me peshat përkatëse paraqiten në Tabelën 3:

²¹ Këtu përfshihen letra me vlerë të investimit, letra me vlerë të tregtueshme dhe të vendosjes dhe mjetet e marra nga ekzekutimi i kolateralit.



Tabela 3: Treguesit dhe nëntreguesit e përdorur nga BSh për të llogaritur notën e rëndësisë sistemike (NRS)

Treguesi	Pesha e kategorisë	Treguesit	Pesha e treguesve
Madhësia	25%	Totali i aktiveve përfshirë zërat jashtë bilancit (TA)	25.00%
Ndërlidhja	25%	Aktivet brenda sistemit financiar (ABS)	8.33%
		Detyrimet brenda sistemit financiar (DBS)	8.33%
		Financimi nëpërmjet borxhit (kapital dhe letra me vlerë të lëshuara nga bankat) (FBKLV)	8.33%
Zëvendësueshmëria	25%	Kredia për sektorin privat (KSP)	5.00%
		Depozitat e sektorit privat (DSP)	5.00%
		Vlera e transaksioneve të pagesave (VP)	5.00%
		Numri i transaksioneve të pagesave (NP)	2.50%
		Investimet në bursë dhe pjesëmarrja në shoqëritë administruese të fondeve (IBF)	2.50%
		Aktivet nën kujdestari (AK)	2.50%
		Aktivet e fondeve të investimit/pensioneve (AFIP)	2.50%
Kompleksiteti	25%	Pretendime ndaj jorezidentëve (PJR)	10.00%
		Detyrime ndaj jorezidentëve (DJR)	5.00%
		Derivativa mbi bankat (OTC)	2.50%
		Investime jo likuide (IJL)	7.50%
	100%		100%

19. Llogaritja e NRS-së për çdo bankë i në kohën j llogaritet sipas formulës (1) ndërkohë që nota sipas secilit tregues (Madhësisë, Ndërlidhjes, Zëvendësueshmërisë dhe Kompleksitetit) për çdo bankë llogaritet sipas formulave 1.1, 1.2, 1.3, dhe 1.4

$$(1) \quad NRS_{ij} = 25\% * (NRS_{Madhësia} + NRS_{Ndërlidhja} + NRS_{Zëvendësueshmëria} + NRS_{Kompleksiteti})$$

$$(1.1) \quad NRS_{Madhësia \ ij} = \left(\frac{TA_{ij}}{\sum_i^n TA_{ij}} * 25\% \right) * 10,000$$

$$(1.2) \quad NRS_{Ndërlidhja \ ij} = 8.33\% * \left(\frac{ABS_{ij}}{\sum_i^n ABS_{ij}} + \frac{DBS_{ij}}{\sum_i^n DBS_{ij}} + \frac{FBKLV_{ij}}{\sum_i^n FBKLV_{ij}} \right) * 10,000$$

$$(1.3) \quad NRS_{Zëvendësueshmëria \ ij} = \left(\frac{KSP_{ij}}{\sum_i^n KSP_{ij}} * 5.00\% + \frac{DSP_{ij}}{\sum_i^n DSP_{ij}} * 5.00\% + \frac{VP_{ij}}{\sum_i^n VP_{ij}} * 5.00\% + \frac{NP_{ij}}{\sum_i^n NP_{ij}} * 2.50\% + \frac{IBF_{ij}}{\sum_i^n IBF_{ij}} * 2.50\% + \frac{AK_{ij}}{\sum_i^n AK_{ij}} * 2.50\% + \frac{AFIP_{ij}}{\sum_i^n AFIP_{ij}} * 2.50\% \right) * 10,000$$

$$(1.4) \quad NRS_{Kompleksiteti \ ij} = \left(\frac{PJR_{ij}}{\sum_i^n PJR_{ij}} * 10.00\% + \frac{DJR_{ij}}{\sum_i^n DJR_{ij}} * 5.00\% + \frac{OTC_{ij}}{\sum_i^n OTC_{ij}} * 2.50\% + \frac{IJL_{ij}}{\sum_i^n IJL_{ij}} * 7.50\% \right) * 10,000$$



-
20. Komiteti i Bazelit nuk përcakton një vlerë-kufi që të përdoret për të ndarë bankat me rëndësi sistemike nga bankat e tjera. Në Dhjetor të vitit 2014, Udhëzimi i EBA-s “Mbi kriteret për përcaktimin e kushteve të zbatimit të Artikullit 131 (3) të Direktivës 2013/36/EU (CRD) lidhur me vlerësimin e Institucioneve të Tjera me Rëndësi Sistemike” përcaktojnë që autoritetet duhet të konsiderojnë si O-SIIs cdo subjekt me një NRS prej 350 pikësh bazë ose më shumë (nga totali prej 10,000 pikësh). Ky kufi mund të rritet deri në 425 pikë bazë ose të ulët deri në 275 pikë bazë për të marrë në konsideratë veçoritë specifike të vendit anëtar të BE-së dhe shpërndarjen statistikore të NRS-ve sipas subjekteve të veçanta.
21. Udhëzimet e EBA-s cilësojnë që “Përvec kuadrit të detyrueshëm, gjykimi mbikëqyrës duhet të përdoret aty ku është e përshtatshme për të pasqyruar karakteristikat e sistemeve bankare kombëtare, në formën e vlerësimit të faktorëve cilësorë dhe sasiorë që janë specifike për vendet e vecanta (Vendet Anëtare të BE-së) dhe që nuk janë kapur ende (në mënyrë të mjaftueshme) nga lidhjet shkak-pasojë të kuadrit të vlerësimit. Kjo praktikë iu mundëson autoriteteve të vlerësojnë dhe të kapin të gjitha institucionet (përveç atyre më të voglave) që ata i konsiderojnë si sistemike, por që nuk janë identifikuar automatikisht si të tilla nga vlerësimi sasior i parashikuar nga kuadri.”
22. Në rastin e Shqipërisë, mbështetur mbi përvojën e vendeve të tjera dhe veçoritë e sistemit bankar shqiptar, është përcaktuar që si kufi minimal për përcaktimin e BARS, të merret vlera prej 800 pikësh bazë, që është një vlerë e përafërt me NRS-në mesatare të sektorit (10,000 pikë bazë / numër bankash)²². Aplikimi i dy kufijve të EBA-s (350 dhe 425 pikë bazë) do të rezultonte në një numër shumë të madh bankash me rëndësi sistemike në raport me numrin e përgjithshëm të bankave që operojnë në Shqipëri, duke relativizuar kuptimin e treguesit.
23. ²³Pavarësisht se një bankë mund të mos identifikohet si me rëndësi sistemike nëpërmjet qasjes së mbështetur në treguesit e mësipërm, Banka e Shqipërisë mund ta klasifikojë atë bankë si të tillë, mbështetur në karakteristika të caktuara të veprimtarisë së bankës që theksojnë profilin e rrezikut dhe rëndësinë e saj për stabilitetin e sistemit financiar. Në këtë rast, Banka e Shqipërisë mund t’i kërkojë bankës të përmbushë një shtesë makroprudenciale të kapitalit jo më të lartë se ajo që i përket shportës së dytë (sipas përcaktimeve në paragrafin 29) dhe për periudhën e kohës së nevojshme derisa banka të ketë adresuar në mënyrë të qëndrueshme shkaqet e klasifikimit. Përfshirja

²² Për efekt ilustrues, grafiku paraqet rezultatet e mbështetura mbi 14 banka që kanë raportuar pranë BSh deri në fund të marsit 2019.


²³ Ndryshuar paragrafi sipas dokumentit të miratuar nga Zëvendësguvernatori i Dytë i Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 828, datë 01.02.2024.



e bankës në grupin e bankave me rëndësi sistemike apo dalja prej tij, nuk sjell automatikisht përfshirjen apo përjashtimin e bankës si subjekt i kërkesave rregullatore që lidhen me mbikëqyrjen mikroprudenciale apo me ndërhyrjen e jashtëzakonshme, me përjashtim të rasteve kur në ato kërkesa rregullatore parashikohet ndryshe.

24. Nga aplikimi i kufirit prej 800 pikësh bazë, sipas të dhënave të fundit të marsit 2019, 4 nga 14 bankat aktive në Shqipëri deri në fund të asaj periudhe, vlerësohen si BARS. NRS-të për secilën nga këto banka janë: Banka A: 2,746 pikë; Banka B: 2,089 pikë; Banka C: 1,437 pikë dhe Banka D: 844 pikë. Të marra së bashku, këto banka kanë rreth 62% të vlerës së treguesit të “Madhësisë” brenda Notës së Rëndësisë Sistemike.


Grafik 1: NRS-të për bankat e sektorit bankar shqiptar dhe kufijtë e EBA dhe BSh për përcaktimin e bankave me rëndësi sistemike



III.A LËVIZJET E BANKAVE DREJT OSE JASHTË GRUPIT TË BANKAVE ME RËNDËSI SISTEMIKE

- 24.1 ²⁴Në rastin e lëvizjes së bankës drejt ose jashtë grupit të bankave me rëndësi sistemike, krahas zbatimit të kërkesave makroprudenciale të kapitalit për rëndësinë sistemike, mund të ndikohen edhe procese të tjera që ndërthuren me proceset e mbikëqyrjes mikroprudenciale dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si edhe pozicioni i bankës tregtare ndaj tyre. Për këto arsye është në interesin e vetë bankave dhe të Bankës së Shqipërisë, që këto lëvizje drejt/jashtë grupit të bankave sistemike të bëhen më të qëndrueshme dhe më të parashikueshme. Për të realizuar këtë proces në mënyrë transparente, vepron si më poshtë:

²⁴ Shtuar paragrafi sipas dokumentit të miratuar nga Zëvendësguvernatori i Dytë i Bankës së Shqipërisë, nr.prot.828, datë 01.02.2024.



-
- a. parakusht për vendimmarrjen lidhur me rëndësinë sistemike të një banke në rastin e lëvizjes së saj drejt/jashtë grupit të BARS është që në kohën e procesit zyrtar të vlerësimit, i cili ndodh në tremujorin e parë të çdo viti, të verifikohet që NRS e bankës për tremujorin e katërt të vitit paraardhës (koha e observimit) është ngjitur mbi ose ka rënë nën, nivelin kufi minimal të shportës së parë;
- b. vetëm për vendimin që do të merret në tremujorin e parë të vitit 2024, për përcaktimin e rëndësisë sistemike të bankës, krahas plotësimit të parakushtit të mësipërm, nevojitet që të verifikohet edhe një 'kusht tranzitor', sipas të cilit NRS e bankës të ketë qëndruar mbi ose të ketë rënë nën, nivelin kufi minimal të shportës së parë për të paktën tre nga katër tremujorët e vitit paraardhës 2023 (duke përfshirë tremujorin e katërt – kohën e observimit). Në vendimin që do të merret në tremujorin e parë të vitit 2025, 'kushti tranzitor' do të zëvendësohet me një kusht tjetër i cilësuar 'kushti përcaktues' sipas të cilit vlera e NRS të ketë qenë mbi ose nën nivelin kufi minimal të shportës së parë në tremujorin e katërt paraardhës. Në këtë mënyrë, me monitorimin e tremujorëve të katërt të vitit korrent dhe të atij paraardhës, vijohet edhe në vlerësimet e viteve të tjera. Zbatimi i kërkesës për kapital për bankat me rëndësi sistemike, ose çlirimi nga kjo shtesë, do të kryhet sipas afateve të parashikuara në rregulloren 41/2019 'Për shtesat makroprudenciale të kapitalit' dhe paragrafit 42 të kësaj metodologjie. Në mënyrë më të detajuar, mënyra e mësipërme e veprimit paraqitet në Aneksin 4;
- c. krahas vlerësimit të NRS së bankave cdo tremujor, Banka e Shqipërisë do të njoftojë bankën në rastin kur ajo është "BARS me rezervë" ose "Tentativë për BARS". Për lehtësi të analizës dhe të komunikimit, si edhe pa asnjë ndikim mbi mënyrën e zbatimit të kërkesës për shtesën përkatëse të kapitalit për rëndësinë sistemike (SIST), banka me rëndësi sistemike mund të etiketohet "BARS me rezervë" në rastin kur NRS e bankës bie nën nivelin kufi minimal të shportës së parë, në kohën e observimit. Në mënyrë të ngjashme, banka mund të etiketohet si "Tentativë për BARS" në rastin kur konstatohet që NRS e bankës ngjitet mbi nivelin kufi minimal të shportës së parë, në kohën e observimit;
- d. Në rastin kur verifikohet në vlerësimin tremujor që NRS e bankës kapërcen nivelin kufi minimal të shportës së parë për shkak të bashkimit të saj me një bankë tjetër, atëherë ajo do të njoftohet menjëherë për pozicionin e saj si "Tentativë për BARS", dhe në varësi të ecurisë së vlerës së NRS së saj ose të vlerësimit sipas paragrafit 23, do të klasifikohet si bankë me rëndësi sistemike në kohën e procesit zyrtar të vlerësimit që vjen menjëherë pas miratimit të bashkimit nga ana e Bankës së Shqipërisë. Për lëvizjet e mëtejshme të bankës brenda grupit të BARS apo daljen e saj, do të zbatohet rregullorja 41/2019 dhe kjo metodologji. Në mënyrë të ngjashme do të veprohet edhe nëse një bankë që është me rëndësi sistemike, ristrukturohet (ndahet, shet një pjesë të aktivitetit të saj) dhe si rezultat
-



verifikohet në vlerësimin tremujor që NRS e saj zbret nën nivelin kufi minimal të shportës së parë. Në këtë rast, nëse nuk vepron sipas paragrafit 23, Banka e Shqipërisë e njofton menjëherë bankën për pozicionin e saj si "BARS me rezervë", dhe në varësi të ecurisë së vlerës së NRS e klasifikon bankën si josistemike në kohën e procesit zyrtar të vlerësimit që vjen menjëherë pas miratimit të ristrukturimit.”;

IV. LLOGARITJA E SHITESËS SË KAPITALIT (SIST) PËR BANKAT ME RËNDËSI SISTEMIKE (BARS)

25. Një nga qëllimet kryesore pas ushtrimit të përcaktimit të bankave me rëndësi sistemike në nivel lokal, është rritja e kapacitetit të tyre për përthithjen e humbjeve, kryesisht nëpërmjet aplikimit të kërkesave për kapital shtesë. Komiteti i Bazelit iu rekomandon juridiksioneve kombëtare që të identifikojnë bankat vendase me rëndësi sistemike dhe të formulojnë një regjim mbikëqyrës dhe rregullator (dhe veçanërisht kërkesa për kapital shtesë) të tillë që të mundësojë uljen e probabilitetit të falimentimit të DSIBs. Udhëzuesit e EBA-s për identifikimin e O-SIIs përcaktojnë që autoritetet kombëtare mund t'i kërkojnë çdo institucioni të identifikuar si një O-SII që të mbajë një shtesë kapitali për rëndësinë sistemike deri në 2% të vlerës së ekspozimit të përgjithshëm, të përbërë nga Kapital Bazë i Nivelit të Parë.
26. Përveç nevojës për të rritur kapacitetin për përthithjen e humbjeve të bankave me rëndësi sistemike, shtesa në kapital për këto banka mendohet se (a) i motivon këto banka për të ulur gjurmën ose impaktin e tyre sistemik, dhe rrjedhimisht ndikimin negativ të falimentimit potencial të tyre në stabilitetin financiar dhe (b) ul avantazhin që kanë këto institucione, si institucione shumë-të-mëdha-për-të-dështuar në tregun e financimit dhe në drejtim të konkurrencës në tregun financiar²⁵.
27. Një nga parimet e Komitetit të Bazelit për madhësinë e shtesës së kapitalit që duhet t'iu kërkojë bankave me rëndësi sistemike, thotë që shtesa e kapitalit duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkallën e rëndësisë sistemike, sipas parimit të proporcionalitetit (shiko Aneksin 2, parimi 9). Për të përmbushur këtë parim, nevojitet që metoda e zgjedhur për të përcaktuar shtesën e kapitalit për çdo subjekt të identifikuar si institucion me rëndësi sistemike të jetë e përshtatshme për të mundësuar kalibrimin e shtesës së kapitalit në mënyrë të tillë që bankave me NRS më të lartë t'iu caktohet një shtesë më e madhe

²⁵ Perceptimi që institucionet me rëndësi sistemike janë shumë-të-mëdha-për-të-dështuar, bën që tregu të presë që, në raste vështirësish, këto institucione të mbështeten nga qeveritë me fonde publike. Ky perceptim deformon sjelljen e këtyre institucioneve dhe të subjekteve që i financojnë ato, në drejtim të rrezikut.



kapitali dhe bankave me NRS të afërta në vlerë t'iu caktohen shtesa të afërta ose të njëjta kapitali për rëndësinë sistemike.

28. Mbështetur në metodologjinë e ndjekur nga Rezerva Federale e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, BSh synon të ndjekë parimin e “ndikimit të pritshëm”, sipas të cilit humbjet e pritshme sistemike nga falimentimi i një banke sistemike duhet të bëhen të krahasueshme në madhësi me humbjet e pritshme nga falimentimi i një banke josistemike. Për të realizuar këtë objektiv, sugjerohet vendosja e kërkesës për shtesa kapitali për bankat sistemike. Mbatja nga bankat me rëndësi sistemike e një raporti më të madh kapitali në krahasim me bankat që nuk kanë rëndësi sistemike pritet të ulë probabilitetin e dështimit të bankave me rëndësi sistemike, dhe, për rrjedhojë, të sjellë në nivele të përafërta dëmin e pritshëm nga falimentimi i një banke me rëndësi sistemike me dëmin e pritshëm nga falimentimi i një banke që nuk ka rëndësi sistemike.
29. Për të përcaktuar shtesën e kapitalit (SIST) për BARS, BSh përdor qasjen e shportave, e cila ofron një nivel më të lartë transparence, si edhe lehtësi në drejtim të komunikimit dhe aplikimit të këtij instrumenti makroprudencial. Kuadri²⁶ parashikon të paktën pesë shporta të rëndësisë sistemike, ku shporta e fundit nuk ka kufi të sipërm (shporta e hapur) dhe katër shportat e tjera kanë madhësi të njëjtë në terma të intervalit të vlerave të NRS-së që mbulojnë (shporta të mbyllura). Duke qenë se çdo bankë me një NRS më të madhe se 800 pikë bazë do të konsiderohet si BARS, kufiri i poshtëm për shportën e parë është 800 pikë bazë dhe madhësia e çdo shporte është 675 pikë bazë. Për shportën e parë, shtesa SIST për bankën që bie në atë shportë do të jetë 0.5%, duke vijuar të rritet me nga 0.5 pikë përqindje deri në shportën e katërt (vlera e agreguar 2%); në shportën e pestë (shporta e hapur), norma e SIST është përcaktuar në 3%. Një bankë përfshihet në një shportë të caktuar nëse vlera e NRS-së së asaj banke është brenda intervalit të vlerave që kufizojnë atë shportë²⁷.
30. Përfshirja e shportës së hapur ka si qëllim të shkurajojë bankat me rëndësi më të madhe sistemike (bankat që gjenden në shportën e katërt të mbyllur) që të bëhen edhe më sistemike. Për të llogaritur SIST për secilën shportë, BSh është mbështetur në metodën e përdorur nga Rezerva Federale. Vlera e mesit e secilës shportë është konsideruar si NRS-ja e bankës sistemike (hipotetike) përfaqësuese për atë shportë, ndërsa vlera-kufi prej 800 pikësh bazë është konsideruar si NRS-ja e bankës referencë ose bankës josistemike për të gjitha shportat.

²⁶ Neni 14, paragrafi (3), nënparagrafi (c) i rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit” të miratuar me Vendim nr. 41, datë 05.06.2019, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.

²⁷ P.sh. një bankë me një NRS të barabartë me 1800 pikë bazë do të përfshihet në shportën që kufizohet nga vlerat 1300 – 1899 pikë bazë.



Tabela 5: Shportat e përdorura për përcaktimin e SIST

Madhësia e shportës (pikë bazë)	Numri i shportës	Intervalet e shportës (pikë bazë)	SIST
675	I	800 - 1475	SIST I
675	II	1476 - 2150	SIST II
675	III	2151 - 2825	SIST III
675	IV	2826 - 3500	SIST IV
	V (e hapur)	> 3500	SIST V

LLOGARITJA E SIST SIPAS SHPORTAVE

31. Humbjet e pritshme (HP) nga falimentimi i një banke mund të llogariten si humbjet në nivel sistemi (sistemike) në rastin e falimentimit (HSF) shumëzuar me probabilitetin e falimentimit të kësaj banke (PF). Kjo marrëdhënie shënohet si:

$$(2) \quad HP = HSF \times PF$$

Duke përdorur përcaktimin BARS për bankat sistemike dhe JBARS për bankat josistemike, marrëdhënia e mësipërme mund të shkruhet si:

$$(1.1) \quad HP_{BARS} = HSF_{BARS} \times PF_{BARS} \quad \text{për bankat sistemike}$$

$$(1.2) \quad HP_{JBARS} = HSF_{JBARS} \times PF_{JBARS} \quad \text{për bankat josistemike}$$

32. Humbjet në nivel sistemik nga falimentimi i një banke sistemike janë shumë më të mëdha sesa humbjet që do të shkakttoheshin në sistem nga falimentimi i një banke josistemike. Pra, $HSF_{BARS} \gg HSF_{JBARS}$ prej ku rrjedh që $HP_{BARS} \gg HP_{JBARS}$ duke qenë se probabilitetet e falimentimit janë të njëjta. Në mënyrë që humbjet e pritshme nga falimentimi i një banke sistemike të barazohen me humbjet e pritshme nga falimentimi i një banke jo-sistemike, është e nevojshme që probabiliteti i falimentimit (PF_{BARS}) të një banke sistemike të zvogëlohet nëpërmjet shtesës së kapitalit, deri në atë masë sa HP_{BARS} të barazohet me HP_{JBARS} ²⁸. Ky kusht mund të shkruhet dhe transformohet sipas barazimit 3, në vijim:

$$(3) \quad HP_{BARS} = HP_{JBARS} \Rightarrow HSF_{BARS} \times PF_{BARS} = HSF_{JBARS} \times PF_{JBARS} \Rightarrow \frac{HSF_{JBARS}}{HSF_{BARS}} = \frac{PF_{BARS}}{PF_{JBARS}}$$

33. Për të llogaritur probabilitetin e falimentimit (PF) të një subjekti çfarëdo të sistemit, në analizën e Rezervës Federale përdoret regresioni (4) në të cilin si variabël i varur merret kthimi nga aktivet e peshuara/

²⁸ Për shembull, në rast se humbja që do të shkakttohej në sistem nga dështimi i një banke sistemike do të ishte dy herë më e madhe nga humbja prej falimentimit të një banke jo-sistemike, banka sistemike duhet të mbajë një nivel kapitali të tillë që probabiliteti i saj i falimentimit të jetë dy herë më i vogël në krahasim me probabilitetin e falimentimit të bankës jo-sistemike.



ponderuara me rrezik²⁹ (RORWA) për secilin nga subjektet për një periudhë disaveçare, dhe si variabël i pavarur merret logaritmi natyror i percentilit përkatës të secilës vlerë të RORWA-s i marrë nga shpërndarja probabilitare. Funkzioni i anasjelltë (5) paraqet probabilitetin që një vlerë e caktuar e RORWA do të jetë e barabartë ose më e vogël se një nivel i caktuar (R^*) në një periudhë të dhënë.

$$(4) \quad RORWA = \alpha + \beta * LN(prob);$$

$$(5) \quad p(R^* \leq RORWA) = p(RORWA) = e^{-\frac{RORWA - \alpha}{\beta}}$$

34. Në mënyrë që një bankë të falimentojë, duhet që ajo bankë të pësojë humbje të tilla (të matura nga RORWA) që kapitali i saj k të bjerë në nivelin f (Barazimi 6). Duke zëvendësuar në funksionin (5) për RORWA, nga barazimi (6) përftohet funksioni (7) si më poshtë:

$$(6) \quad k + RORWA = f \Rightarrow RORWA = f - k$$

$$(7) \quad PF(k) = e^{-\frac{f-k-\alpha}{\beta}} = e^{-\frac{(f-\alpha)-k}{\beta}}$$

35. Nëse probabiliteti i falimentimit të një banke referencë (një banke josistemike) dhe probabiliteti i falimentimit të një banke sistemike, shkruhen si funksione të kapitalit që mban secila prej dy llojeve të bankave³⁰, kushti (3) mund të rishkruhet si (8):

$$(8) \quad \frac{HSF_{JBARS}}{HSF_{BARS}} = \frac{PF_{BARS}}{PF_{JBARS}} = \frac{e^{f-\alpha-k_{BARS}}}{e^{f-\alpha-k_{JBARS}}} = \frac{e^{f-\alpha-k_{JBARS}-SIST}}{e^{f-\alpha-k_{JBARS}}} = e^{-\frac{SIST}{\beta}}$$

Ku k_{JBARS} është kapitali që mban një bankë çfarëdo e sistemit dhe SIST është shtesa e kapitalit për rëndësinë sistemike që bankat sistemike mbajnë mbi nivelin k_{JBARS} të kapitalit.

36. Për të zgjidhur ekuacionin (8) për të panjohurën SIST nevojitet informacion mbi dy përbërësit e raportit në anën e majtë. Si një tregues për afrues për humbjet sistemike që vijnë nga secila bankë e sistemit mund të përdoret nota e rëndësisë së saj sistemike me marrëveshjen që (a) sa më e rëndësishme të jetë një banke nga këndvështrimi sistematik, aq më e madhe është humbja sistemike që falimentimi i saj shkakton në sistem dhe (b) vetëm raporti i notave të rëndësisë sistemike dhe jo vlerat e notave në vetvete (NRS e bankës jo-sistemike ndaj NRS-së së bankës sistemike) është i rëndësishëm për zgjidhjen e ekuacionit (8).

²⁹ RORWA propozohet si një tregues më i përshatshëm për të matur rrezikun në krahasim me Kithimin nga Aktivitet (RoA) sepse peshat e rrezikut në treguesin RORWA janë kalibruar për të siguruar që dy portofole me vlera të njëjta aktivesh të peshuara me rrezik, kanë nivele të përafërta rreziku, ndërkohë që dy portofole me vlera të përafërta aktivesh, mund të kenë nivele shumë të ndryshme rreziku në varësi të klasave të aktiveve që përbëjnë secilin.

³⁰ Banka sistemike dhe banka jo-sistemike.



$$(9) \frac{HSF_{JBARS}}{HSF_{BARS}} = \frac{NRS_{JBARS}}{NRS_{BARS}} = e^{-\frac{SIST}{\beta}} \Rightarrow SIST = -\beta \times \ln\left(\frac{NRS_{JBARS}}{NRS_{BARS}}\right)$$

LLOGARITJA E SIST SIPAS SHPORTAVE: REZULTATET

37. Vlera e SIST për secilën nga shportat e paraqitura në Tabelën 6, është llogaritur duke përdorur formulën e paraqitur në barazimin (9) më lart. Si NRS_{JBARS} është konsideruar vlera prej 800 pikësh bazë që është përdorur si vlerë-kufi për të ndarë bankat sistemike nga bankat josistemike. Si NRS_{BARS} për secilën shportë është përdorur vlera e mesit e intervalit të vlerave të NRS që kufizojnë shportën.
38. Për të vlerësuar koeficientin β është vlerësuar regresioni i barazimit(4). Si vlera të RORWA³¹ janë marrë të dhënat tremujore për çdo bankë të sektorit bankar vendas për periudhën T1 2005 – T4 2018. Rezultatet e regresionit tregojnë që koeficienti α është i barabartë me -0.56, dhe koeficienti β është i barabartë me 2.05. Ndaj barazimi (4) mund të rishkruhet si:

$$RORWA = -0.56 + 2.05 * LN(prob)$$


39. Duke përdorur formulën $SIST = -\beta \times \ln\left(\frac{NRS_{JBARS}}{NRS_{BARS}}\right)$ është llogaritur SIT për secilën nga 4 shportat e mbyllura. Për shportat I, II, III, IV, modeli sugjeron SIST të barabarta me 0.72%, 1.68%, 2.33% dhe 2.82%. Duke rikalibruar këto vlera për intervalin prej 0-2% të SIST për katër shportat e mbyllura, përftohen vlerat 0.5%, 1.2%, 1.7% dhe 2% të cilat përafrohen në vlerat 0.5%, 1.0%, 1.5% dhe 2.0%.

Tabela 6: Vlerat e SIST sipas shportave

Madhësia e shportës (pikë bazë)	Emërtimi i shportës	Intervalet e shportës (pikë bazë)	Pika e mesit të shportës	SIST sipas modelit	SIST e kalibruar në intervalin 0%-2%	SIST e propozuar (e përafër në shumëfishin më të afërt të 0.5%)
	Jo-sistemike	< 800				0.0%
675	I	800 - 1475	1138	0.72%	0.5%	0.5% (SIST I)
675	II	1476 - 2150	1813	1.68%	1.2%	1.0% (SIST II)
675	III	2151 - 2825	2491	2.33%	1.7%	1.5% (SIST III)
675	IV	2826 - 3500	3163	2.82%	2.0%	2.0% (SIST IV)
	V	> 3500				3.0% (SIST V)


40. Nëse secila nga katër bankat e identifikuar si BARS në paragrafin 24 vendoset në shportën përkatëse në bazë të NRS-së, Banka A me një NRS prej 2,746 pikësh përfshihet në shportën III me SIST-in

³¹ RORWA ose kthimi nga aktivet e peshuara me rrezik për çdo bankë për çdo tremujor llogaritet si raport i rezultatit neto pas taksave me aktivet e peshuara me rrezik.



përkatës prej 1.5%, Banka B me NRS të barabartë me 2,089 pikë përfshihet në shportën II me SIST-in perkates prej 1.0% dhe bankat C dhe D me NRS përkatësisht të barabarta me 1,437 pikë dhe 844 pikë përfshihen në shportën I me SIST-in përkatës prej 0.5%.

Grafik 2: Renditja e bankave sipas NRS dhe klasifikimi sipas shportave



V. PROCESI I ZBATIMIT

41. Për zbatimin e shtesës në kapital për bankat me rëndësi sistemike, mbështetur në përcaktimet e rregullores nr.41, datë 05.06.2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit", BSh do të realizojë:
 - një proces të rregullt monitorimi, që do të kryhet çdo tremujor;
 - një proces zyrtar vlerësimi që do të kryhet një herë në vit, kryesisht në tremujorin e parë të vitit 't', mbështetur në treguesit e tremujorit të katërt të vitit 't-1';
 - shpalljen e BARS dhe të SIST-eve përkatës.

42. Mbështetur në vlerën e NRS në momentin e vlerësimit, në rastin kur banka bëhet sistemike ose ka rritur rëndësinë e saj sistemike duke kaluar në një shportë më të lartë, bankës do t'i kërkohet që vlera e shtuar e shtesës në kapital për rëndësinë sistemike të realizohet brenda një periudhe jo më të gjatë se 12 muaj (nga 1 janari i vitit 't+1'). Në rastin kur banka nuk identifikohet më tej si "me rëndësi sistemike", ose kur ajo ka ulur rëndësinë e saj sistemike duke zbritur në një shportë më të ulët, atëherë ulja e shtesës në kapital mund të realizohet menjëherë pas njoftimit. Në rastin kur banka ka ruajtur të njëjtën shportë të rëndësisë së saj sistemike, shtesa në kapital do të mbetet e pandryshuar deri në vlerësimin vijtor të radhës.



ANEKS 1. KRONOLOGJIA E ZHVILLIMEVE LIDHUR ME KUADRIN E INSTITUCIONEVE FINANCIARE ME RËNDËSI SISTEMIKE (SIFIS)

Nëntor 2009: FMN, BIS, FSB publikojnë: "Guidance to Assess the Systemic Importance of Financial Institutions, Markets and Instruments: Initial Considerations" në përgjigje të një kërkesë të bërë nga liderat e G20 në prill 2009 për të udhëhequr autoritetet kombëtare rreth vlerësimit të rëndësisë sistemike të institucioneve financiare, tregjeve dhe instrumenteve.

Link: (<http://www.bis.org/publ/othp07.htm>)

Tetor 2010: FSB publikon rekomandimet për zbutjen e dëmit moral të shkaktuar nga aktiviteti e institucioneve financiare me rëndësi sistemike: FSB, "Reducing the moral hazard posed by systemically important financial institutions"

Link: http://www.financialstabilityboard.org/publications/r_101111a.pdf

Tetor 2011: FSB publikon një kuadër final politikash për mbikëqyrjen e institucioneve me rëndësi sistemike. FSB, "Intensity and Effectiveness of SIFI Supervision: Progress report on implementing the recommendations on enhanced supervision".

Link: http://www.financialstabilityboard.org/publications/r_111104ee.pdf

Nëntor 2011: BCBS publikon metodologjinë për përcaktimin e GSIBs dhe kuadrin rregullator për kërkesat për kapitalin shtesë për përthithjen e humbjeve për GSIBs. "Global systemically important banks: assessment methodology and the additional loss absorbency requirement – Rules text and Cover note"

Link: <http://www.bis.org/publ/bcbs207.htm>

Nëntor 2011: FSB publikon listën e 29 bankave të identifikuara si GSIBs. FSB, "Annex to Policy Measures to Address Systemically Important Financial Institutions".

Link: http://www.financialstabilityboard.org/publications/r_111104bb.pdf

Nëntor 2011: FSB publikon një kuadër politikash për regjimet e zgjidhjeve ("Key Attributes") që vendet e G20 duhet të zbatojnë për të zgjidhur në mënyrë efikase institucionet me rëndësi sistemike. FSB, "Key Attributes of Effective Resolution Regimes for Financial Institutions".

Link: http://www.financialstabilityboard.org/publications/r_111104cc.pdf



-
- Në 2011, u themeluan gjashtë grupe konsultative të Bordit të Stabilitet Financiar (BSF) për të bashkuar autoritetet financiare nga vende anëtare dhe jo të BSF për të shkëmbyer këndvështrime rreth dobësive në sistemet financiare dhe iniciativat për promovimin e stabilitetit financiar.
 - Shtirja e kuadrit rregullator për institucionet me rëndësi sistemike globale drejt bankave me rëndësi sistemike vendase. Kuadri rregullator akoma në zhvillim.

FSB, A Progress Report submitted to G-20 Ministers and Governors on 16 April 2012 http://www.financialstabilityboard.org/publications/r_120420b.pdf

- Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare ka zgjeruar kuadrin rregullator për institucionet me rëndësi sistemike globale me rekomandime për identifikimin dhe kuadrin e politikave për institucionet me rëndësi sistemike globale.

BCBS, "A framework for dealing with domestic systemically important banks", (Oct. 2012), e disponueshme në <http://www.bis.org/publ/bcbs224.pdf>



ANEKS 2: PARIMET E KOMITETIT TË BAZELIT PËR MBIKQYRJEN BANKARE (BCBS) PËR TRAJTIMIN E BANKAVE ME RËNDËSI SISTEMIKE NË NIVEL LOKAL (BARS)

Metodologjia e vlerësimit

Parimi 1: Autoritetet kombëtare duhet të hartojnë një metodologji për vlerësimin e masës në të cilën bankat janë të rëndësishme në kontekstin lokal (vendas).

Parimi 2: Metodologjia e vlerësimit të BARS duhet të reflektojë ndikimin potencial të dështimit të një banke në sistemin financiar dhe ekonominë e vendit.

Parimi 3: Sistemi i referencës për vlerësimin e ndikimit të dështimit të një BARS duhet të jetë ekonomia vendase.

Parimi 4: Autoritetet e vendit nga e ka origjinën banka duhet të kryejnë vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në nivel të konsoliduar grupi, ndërsa autoritetet pritëse duhet t'i vlerësojnë filialet që operojnë në juridiksionin e tyre, të konsoliduara, për të përfshirë çfarëdolloj filiali /biznesi të rrjedhur prej këtyre filialeve brenda juridiksionit pritës.

Parimi 5: Ndikimi i dështimit të një BARS në ekonominë vendase, në parim duhet të bëhet duket konsideruar faktorë specifike të bankës si më poshtë:

- (a) Madhësia;
- (b) Ndërlidhja;
- (c) Zëvendësueshmëria/infrastruktura e institucionit financiar (duke përfshirë konsiderata të lidhura me shkallën e përfqendrimit të sektorit bankar); dhe
- (d) Kompleksiteti (duke përfshirë kompleksitetin që vjen nga aktiviteti ndër-kufitar).

Gjithashtu, autoritetet kombëtare mund të konsiderojnë matje/të dhëna të tjera për të ndërtuar treguesit që përbëjnë notën e rëndësisë sistemike, brenda secilit nga faktorët e lartpërmendur si p.sh. madhësia e ekonomisë vendase.

Parimi 6: Autoritetet kombëtare duhet të kryejnë vlerësime të rregullta (në kohë) të rëndësisë sistemike të bankave brenda juridiksionit të tyre për të siguruar që vlerësimi reflekton situatën korrente të sistemeve financiare dhe intervali midis dy vlerësimeve të njëpasnjëshme nuk duhet të jetë shumë më i gjatë sesa sa intervali i vlerësimit të bankave me rëndësi sistemike në nivel global (GSIB).

Parimi 7: Autoritetet kombëtare duhet të publikojnë informacion mbi metodologjinë e përdorur për të vlerësuar rëndësinë sistemike të bankave në ekonominë vendase.



Përthithja më e lartë e humbjeve (shtesa e kapitalit për rëndësinë sistemike - SIST)

Parimi 8: Autoritetet kombëtare duhet të dokumentojnë metodologjitë dhe konsideratat e përdorura për të kalibruar nivelin e SIST për bankat nën juridiksionin e tyre. Niveli i SIST duhet të mbështetet mbi metodologji sasiore dhe faktorët specifikë të vendit pa paragjykuar përdorimin e gjykimit mbikëqyrës.

Parimi 9: SIST që aplikohet mbi çdo BARS duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkallën e rëndësisë sistemike të asaj banke, në bazë të vlerësimit të kryer sipas Parimit nr.5.

Parimi 10: Autoritetet kombëtare duhet të sigurojnë që zbatimi i kuadrit rregullator për bankat me rëndësi sistemike në nivel lokal (BARS) dhe për bankat me rëndësi sistemike në nivel global (GSIB) të jetë në përputhje me juridiksionet e tyre. Autoritetet e vendit të origjinës së bankës duhet të vendosin SIST të kalibruara në nivel mëmë dhe/ose nivel të konsoliduar, dhe autoritetet pritëse duhet të vendosin SIST të kalibruara në nivel të nënkonsoliduar/në nivel filiali.

Autoriteti i vendit të origjinës duhet të sigurohet që banka mëmë është e mirëkapitalizuar në baza vetjake (stand-alone) duke përfshirë rastet kur filiali i saj është subjekt i një SIST në shtetin/et pritës/e.

Autoriteti i vendit të origjinës duhet të aplikojë kërkesën më të lartë të SIST në rastet kur grupi bankar është identifikuar njëkohësisht si BARS dhe si GSIB.


Parimi 11: Në rastet kur filiali i një banke identifikohet si BARS nga një vend pritës, autoriteti i vendit të origjinës dhe autoriteti i vendit pritës duhet të koordinohen dhe të bashkëpunojnë për të përcaktuar nivelin e përshtatshëm të SIST, brenda kufizimeve të përcaktuara nga kuadri ligjor në juridiksionin pritës.

Parimi 12: SIST duhet të plotësohet në të gjithë madhësinë e saj nga Kapital i Nivelit të Parë (CET1). Gjithashtu, autoritetet kombëtare duhet të vendosin kërkesa shtesë dhe masa të tjera rregullative që i konsiderojnë të nevojshme për të adresuar rreziqet që vijnë nga BARS.



ANEKS 3: QASJET NË PËRCAKTIMIN E TREGUESVE DHE NËNTREGUESVE TË RËNDËSISË SISTEMIKE, SIPAS BCBS, EBA DHE BSH

		BCBS	EBA	BSh
1	Kampioni i bankave	73 bankat më të mëdha në nivel global të renditura sipas notës së rëndësisë sistemike	Autoritetet kombëtare mund të përjashtojnë nga kampioni institucione të cilat konsiderohet se nuk paraqesin rrezik sistematik ndaj ekonomisë vendase	Të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja që kryejnë aktivitetet në Shqipëri
2	Treguesit	Pesë tregues (1) Aktiviteti ndërkufitar (2) Madhësia (3) Ndërlidhja (4) Zëvendësueshmëria (5) Kompleksiteti	Katër tregues (1) Madhësia (2) Rëndësia (duke përfshirë zëvendësueshmërinë/infrastrukturën) (3) Kompleksiteti/aktiviteti ndërkufitar (4) Ndërlidhja	Katër tregues (1) Madhësia (2) Rëndësia (duke përfshirë zëvendësueshmërinë/infrastrukturën) (3) Kompleksiteti/aktiviteti ndërkufitar (4) Ndërlidhja
3	Peshat e treguesve/nëntreguesve	Të gjithë treguesit kanë pesha të barabarta; kategoria e zëvendësueshmërisë ka një kufi të sipërm	Të gjithë treguesit dhe nëntreguesit brenda treguesve kanë pesha të barabarta;	Të gjithë treguesit dhe nëntreguesit brenda treguesve kanë pesha të barabarta;
4	Kufiri ndarës	Bankat me një notë më të lartë se kufiri ndarës i përcaktuar nga BCBS klasifikohen si GSIB.	Institucionet me një notë të barabartë ose më të lartë se 350 pikë bazë (nga totali prej 10,000 pikësh) duhet të konsiderohen si Institucione të Tjera Financiare me Rëndësi Sistemike. Autoritetet mund ta ulin këtë kufi deri në 275 pikë ose ta ngrenë deri në 425 pikë për të marrë në konsideratë karakteristikat e shtetit përkatës.	Bankat me një notë të barabartë ose më të lartë se 800 pikë bazë (nga totali prej 10,000 pikësh) duhet të konsiderohen si Banka me Rëndësi Sistemike në (BARS).



³²ANEKS 4: MËNYRA E VEPRIMIT PËR LËVIZJEN E BANKAVE DREJT OSE JASHTË GRUPIT TË BANKAVE ME RËNDËSI SISTEMIKE

Për lëvizjen e bankave drejt/jashtë grupit të bankave me rëndësi sistematike (BARS), mund të ketë dy situata: (a) banka X lëviz drejt grupit të BARS (ngjitet mbi nivelin minimal të shportës së parë të grupit të BARS); dhe /ose (b) banka sistematike Y lëviz jashtë grupit të BARS (bie nën nivelin minimal të shportës së parë). Në këto situata, elementet dhe hapat kryesorë të vlerësimit, përfshijnë:

Për a):

- a1. Koha e procesit zyrtar të vlerësimit: **T1_t**, Mars 2024, kur vlerësohet nota e rëndësisë sistematike (NRS) të bankës X;
- a2. Koha e observimit: **T4_{t(-1)}**, Dhjetor 2023, ku merren të dhënat që mundësojnë vlerësimin e NRS për vendimin ;
- a3. Nga vlerësimi i NRS së bankës, konstatohet që vlera e saj në kohën e observimit ka kapërcyer nivelin kufi minimal të shportës së parë, pra plotësohet parakushti;
- a4. Periudha mbi të cilën bëhet vlerësimi i T1-2024: viti paraardhës 2023:
 - (i) nëse në të paktën 3 tremujorë³³ të vitit 2023 (p.sh. krahas T4-2023, edhe në T1 e T2), banka X e ka patur NRS mbi nivelin kufi minimal të shportës së parë, atëherë plotësohet '**kushti tranzitor**' dhe X klasifikohet si BARS;
 - (ii) nëse kushti tranzitor nuk plotësohet, atëherë banka X nuk klasifikohet si BARS³⁴;
- a5. Në rastin e pikës a4(ii) më sipër, nëse në vlerësimin vijues, pra në atë të T1-2025, konfirmohet që NRS e bankës X për T4-2024 ndodhet mbi nivelin kufi minimal të shportës së parë, në mënyrë të ngjashme si në T4-2023, atëherë është plotësuar '**kushti përcaktues**' dhe X klasifikohet si BARS. Nëse kushti përcaktues nuk plotësohet, banka X nuk klasifikohet si BARS;

Në këtë mënyrë, me monitorimin e tremujorëve të katërt të vitit korrent dhe të atij paraardhës, vijohet edhe në vlerësimet e viteve të tjera.

Për b):

- b1. Koha e procesit zyrtar të vlerësimit dhe koha e observimit, janë elementë të njëjtë siç përcaktohet në pikat a1 dhe a2, më sipër;
- b2. Nga vlerësimi i NRS së bankës, konstatohet që vlera e saj ka rënë nën nivelin kufi minimal të shportës së parë, pra plotësohet parakushti;

³² Ndryshuar aneksi sipas dokumentit të miratuar nga Zëvendësguvernatori i Dytë i Bankës së Shqipërisë, nr.prot.828, datë 01.02.2024.

³³ Fundi i tremujorit.

³⁴ Rasti i "Tentative për BARS";



-
- b3. Periudha mbi të cilën bëhet vlerësimi i T1-2024: viti paraardhës, 2023:
- (i) nëse në të paktën 3 tremujorë³⁵ të vitit 2023(p.sh. krahas T4-2023, edhe në T1 e T2), banka Y e ka patur NRS nën nivelin kufi minimal të shportës së parë, atëherë plotësohet '**kushti tranzitor**' dhe Y nuk klasifikohet si bankë me rëndësi sistemike;
 - (ii) nëse kushti tranzitor nuk plotësohet, atëherë banka Y mbetet si BARS³⁶;
- b.4 Në rastin e pikës b3(ii) më sipër, nëse në vlerësimin vijues, pra në atë të T1-2025, konfirmohet që NRS e bankës Y për T4-2024 ndodhet nën nivelin kufi minimal të shportës së parë, në mënyrë të ngjashme si në T4-2023, atëherë është plotësuar '**kushti përcaktues**' dhe Y nuk klasifikohet si bankë me rëndësi sistemike. Nëse kushti përcaktues nuk plotësohet, banka Y mbetet si BARS;

Në këtë mënyrë, me monitorimin e tremujorëve të katërt të vitit korrent dhe të atij paraardhës, vijohet edhe në vlerësimet e viteve të tjera.

³⁵ Fundi i tremujorit.

³⁶ Rasti i "Tentativë për BARS";

